




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Zyra e Prokurimit

Dt. 07.04.2023

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 37 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) në lidhje me kontratën me nr. të prokurimit: 632-21-8848-1-1-1, numër të brendshëm 632-21-147-111 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-21077, për shkak të mos-përbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktorit: "INTRAST" SH.P.K., Lidhja e Prizrenit 22/1- kat/III/1, Prishtinë, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 07.04.2023, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM

Për ndërprerjen e Kontratës

1. Për shkak të dështimit për të përbushur obligimet kontraktuale, që parqet element thelbësorë të kontratës, Kontrata me numër të prokurimit: : 632-21-8848-1-1-1, numër të brendshëm 632-21-147-111 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-21077, e datës 01.09.2022, për realizimin e kontratës: 'Pajimet dhe sinjalizimi trafikut rrugor' e lidhur mes në mes të AK Komuna e Gjakovës dhe OE "INTRAST" SH.P.K, me seli në rr. Lidhja e Prizrenit 22/1- kat/III/1, Prishtinë, NDËRPRITET.
2. Për shkak se Kontraktuesi: "INTRAST" SH.P.K, me seli në rr. Lidhja e Prizrenit 22/1- kat/III/1, Prishtinë, është përgjegjës për mos përbushje të obligimeve që dalin nga kontrata, obligime këto që janë kusht esenciale dhe themelor i kontratës, NDËRPRITEN së vepruari të gjitha raportet dhe marrëdhëniet Autoritet Kontraktues – Kontraktuesi, të rregulluara me Kontratën me numër të prokurimit: : 632-21-8848-1-1-1, numër të brendshëm 632-21-147-111 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-21077, të datës 01.09.2022, për çka Autoriteti Kontraktues, do të kërkoj konfiskimin e sigurimit të ekzekutimit për kompensimin e dëmit të shkaktuar.
3. Me qëllim të kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga veprimet e pajustificuara të Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktues do të ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale – ligjore në pajtim me Kushtet e Kontratës.
4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Punëdhënësit, ka iniciuar aktivitetin për: "Pajimet dhe sinjalizimi trafikut rrugor", të dt.01.09.2022, me O.E: "INTRAST" SH.P.K., Lidhja e Prizrenit 22/1- kat/III/1, Prishtinë, për kryerjen e punëve të kontraktuara sipas Kontratës.

Me qëllim të menaxhimit dhe zbatimit në kohë dhe në mënyrë cilësore të kontratës, Zyratari Kryesorë Administrativ i Autoritetit Kontraktues – Ardian Gjini, Kryetari i Komunës, me Vendimin e tij 01nr. 112/02-21037 dt.26.08.2022, ka emëruar Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës, me të drejta dhe obligimet sikurse janë përcaktuar në Vendim.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi të tija, përmes kërkesës dërguar në rrugë elektronike dhe kopje fizike në Zyrën e Prokurimit, me datë 05.04.2023, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së Prokurimit ndërprerjen e Kontratës për mos realizim të kontratës konform kushteve të kontratës.

Duke qenë se Kontraktuesi: " INTRAST " SH.P.K., Lidhja e Prizrenit 22/1- kat/III/1, Prishtinë,, në vazhdimësi, dhe deri më sot, dt.07.04.2023, nuk është përgjigjur pozitivisht në kërkesat e AK Komuna e Gjakovës. për të kryer të gjitha punët sipas kërkesave teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit , këto veprime të Kontraktuesit, nga ana e AK Komuna e Gjakovës, janë vlerësuar të paarsyeshme, prandaj kontrata ndërpritet duke u bazuar në nenin 26, paragrafi 26.1 nën: a, b, dhe c, të Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme.

Bazuar në këtë që u tha më lartë, AK Komuna e Gjakovës, përfundimisht ka vlerësuar se Kontraktuesi " INTRAST " SH.P.K., Lidhja e Prizrenit 22/1- kat/III/1, Prishtinë, duke mos zbatuar kërkesat e AK Komuna e Gjakovës, për zbatim të plotë të kontratës, është përgjegjës për shkak të dështimit të tij për të kryer punët e kontraktuara konform kërkesave dhe Specifikave Teknike të shërbimit.

Andaj, për arsytet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nën 72 të Rregullave të Prokurim Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Ardian Gjin

Kryetari i Komunës

Faton Guri

Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Drejtorisë për Infrastrukturë;
Drejtorisë për Buxhet dhe financa
Menaxherit të kontratës;
Arkivës së Komunës.